

VENDIM
Nr.186, datë 19.3.2026

PËR SHPALLJEN E SITUATËS SË VEÇANTË NË TREGUN E
HIDROKARBUREVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 21/1, të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 21/1, të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi deri në një vendimmarrje të dytë nga ana e Këshillit të Ministrave.

2. Gjatë periudhës së situatës së veçantë ngrihet dhe funksionon Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit, i cili ushtron detyrat e sipas kompetencave të përcaktuara në kreun III/1, të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, të ndryshuar.

3. Subjektet dhe institucionet e përcaktuara në shkronjat “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 2, të nenit 21/2, të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, të ndryshuar, detyrohen që, brenda datës 24.3.2026, të njoftojnë pranë ministrit përgjegjës për ekonominë përfaqësuesit e tyre në përbërje të këtij bordi.

4. Çmimet, që përcaktohen nga Bordi gjatë situatës së veçantë, janë të detyrueshme për të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e tregtimit të nënprodukteve të naftës dhe të gazit në vend, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si dhe subjektet e licencuara për veprimtari me shumicë dhe pakicë në tregun e hidrokarbureve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama